



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1010/26 prot

Datë 24.07.2024

V E N D I M
Nr. 961/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.07.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 621/2024, datë 04.06.2024 dhe Nr.840/2024, datë 09.07.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NUIS K21511002I dhe adresë: Rruga ‘Shefqet Musaraj’ banesa nr.17, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor** Spitali Rajonal Durrës
Lagja nr.8, Rr.A.Goga, Durres.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 04.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 621/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "ALMedical" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur e thjeshtuar", me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: "Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës", me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 29.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.*
 - 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
 - 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 - 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "ALMedical" SHPK.*
 - 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Në datën 03.07.2024 është protokolluar në KPP me nr. 1010/17 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, nr. 833/13 prot., datë 02.07.2024 me anë të së cilës AK bën me dije se: "[...] nga ana e autoritetit është e pamundur teknikisht të bëhet një veprim i tillë, pasi procedura e kaluar fazën e ndryshimit të dokumentave të tenderit dhe ka vijuar me fazën e dytë, atë të vlerësimit të ofertave, në të cilën nuk mund të bëhet ngarkim i shtojcës për ndryshim të DST-së. Kjo për shkak se pezullimi i procedurës në SPE është bërë në fazën e vlerësimit të ofertave, [...] konkretisht dijenia mbi ankesën nga ana jonë është marrë jo me datë 25.04.2024 (data e regjistrimit të ankesës në KPP) por me datë 30.04.2024 në faqen e KPP-së, pra pas datës 29.04.2024 (data e hapjes dhe e vlerësimit të ofertave). Ndodhur në kushtet e mësipërme kërkojmë heqjen e pezullimit në mënyrë që të vijomë me hedhjen e rë të procedurës me ndryshimet e konstatuara nga ana juaj."

I.3. Në datë 09.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 840/2024, ku vendosi:

- 1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur e thjeshtuar", me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: "Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës", me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës".*

2. *Autoriteti kontraktor të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit dhe të dërgojë së bashku me formularin e anulimit edhe shtojcën e modifikuar të dokumentave të tenderit, në zbatim të vendimit 621/2024, datë 04.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.*

3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Në datën 18.07.2024 është protokolluar në KPP me nr. 1010/22 prot., shkresa e shoqërisë “Almedical” SHPK me datë 17.07.2024 me objekt: “Zbatim i vendimit nr. 621/2024 të KPP, nga AK”. Me anë të kësaj shkrese operatori ekonomik ankimues informon se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar vendimin nr. 840/2024, datë 09.07.2024 të KPP-së por ka dalë me një procedurë të re të prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.Ref-13176-07-15-2024, me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës”, me fond limit 4.546.300 lekë me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës”, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Sipas ankimuesit: “Në shtojcën 7 është kërkuar përsëri të paraqiten autorizimet e prodhuesve: “Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe të noterizuar), që KPP i hoqi me anë të vendimit 621/2024 dhe është kërkuar përsëri paraqitja e mostrave, por në një formë tjetër: “Referuar Vendimit të KPP me nr 621/2024 date 04.06.2024 dhe nr. 833/4 prot date 07.06.2024 , por mostrat do të shikohen/vlersohen në momentin e dyte procedural të kontrollit ex-post, pas lidhjes së kontrates, ku komisioni perkates i pritjes së mallit duhet të kontrolloj perputhshmerine e produkteve të furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar nga autoritetit kontraktor”, duke cënuar përsëri konkurrencën e lirë ndërmjet operatorëve ekonomikë që vetëm operatori ekonomik i paracaktuar si fitues i ka mostrat e kërkuara nga AK. Gjithashtu për artikujt që OE Almedical u ankimua, janë të kompanisë Bausch që për të sjellë këto produkte ju përgjigjet vetëm një kompani distributore në Shqipëri. Pra autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar aspak vendimin e KPP-së, duke mospasqyruar ndryshimet në procedurën aktuale për të cilën u bë ankesa.”

I.5. Në datën 22.07.2024 është protokolluar në KPP me nr. 1010/23 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, nr. 833/15 prot., datë 19.07.2024 me anë të së cilës AK bën me dije se ka zbatuar vendimin nr. 840/2024 të KPP-së, datë 09.07.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës”, bashkëngjitur Formular i njoftimit të anulimit të procedurës me Nr. REF-01878-04-18-2024, Urdhëri i prokurimit për procedurën e re; proscverbali i ndryshimit të DT-ve, Njoftimi i shkurtuar i kontratës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Në datën 18.07.2024 është protokolluar në KPP me nr. 1010/22 prot., shkresa e shoqërisë “Almedical” SHPK me datë 17.07.2024 me objekt: “Zbatim i vendimit nr. 621/2024 të KPP, nga AK”. Me anë të kësaj shkrese operatori ekonomik ankimues informon se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar vendimin nr. 840/2024, datë 09.07.2024 të KPP-së por ka dalë me një procedurë të re të prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.Ref-13176-07-15-2024, me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës”, me fond limit 4.546.300 lekë me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës”, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Sipas ankimuesit: “Në shtojcën 7 është kërkuar përsëri të paraqiten autorizimet e prodhuesve: “Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejinin e tregtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe të noterizuar), që KPP i hoqi me anë të vendimit 621/2024 dhe është kërkuar përsëri paraqitja e mostrave, por në një formë tjetër: “Referuar Vendimit të KPP me nr 621/2024 date 04.06.2024 dhe nr. 833/4 prot date 07.06.2024, por mostrat do të shikohen/vlersohen në momentin e dyte procedural te kontrollit ex-post, pas lidhjes se kontrates, ku komisioni perkates i pritjes se mallit duhet te kontrolloj perputhshmerine e produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar nga autoritetit kontraktor”, duke cënuar përsëri konkurrencën e lirë ndërmjet operatorëve ekonomikë që vetëm operatori ekonomik i paracaktuar si fitues i ka mostrat e kërkuara nga AK. Gjithashtu për artikujt që OE Almedical u ankimua janë të kompanisë Bausch që për të sjellë këto produkte ju përgjigjet vetëm një kompani distributore në Shqipëri. Pra autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar aspak vendimin e KPP-së, dhe mospasqyruar ndryshimet në procedurën aktuale për të cilën u bë ankesa.”

II.2. Në datën 22.07.2024 është protokolluar në KPP me nr. 1010/23 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, nr. 833/15 prot., datë 19.07.2024 me anë të së cilës AK bën me dije se ka zbatuar vendimin nr. 840/2024 të KPP-së datë 09.07.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01878-04-18-2024, me objekt: “Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rjonal Durrës”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës, bashkëngjitur Formular i njoftimit të anulimit të procedurës me Nr. REF-01878-04-18-2024, Urdhëri i prokurimit për procedurën e re; proscverbali i ndryshimit të DT-ve, Njoftimi i shkurtuar i kontratës.

II.3. Referuar shkresave të mësipërme, të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK dhe autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Durrës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit në zbatim të vendimit nr.840/2024 datë 09.07.2024 të KPP-së, por ka vazhduar me publikimin e procedurës së re të prokurimit, pa paraqitur më parë shtojcën e modifikuar të dokumentave të tenderit, sikurse është vendosur në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 840/2024 të KPP-së datë 09.07.2024.

Gjithashtu, referuar shkresës së mësipërme nr. 833/15 prot., datë 19.07.2024, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj shkrese, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar pikën III.4 të arsyetimit të vendimit nr. 621/2024, datë 24.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik ku thuhet shprehimisht:

*“III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK se: “Ne shtojcen 7 ‘Kriteret e Veçanta të Kualifikimit’ autoriteti kontraktor ka kerkuar qe operatori ekonomik te paraqese autorizim prodhuesi: ‘Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe të noterizuar). Per artikujt e sipermendur autoriteti kontraktor ka permendur emer brendi Stellaris dhe pikerisht specifikimet teknike jane hartuar sipas produkteve te ketij brendi qe eshte e kompanise prodhuese Bausch. Nderkohe termi ‘ekuivalent’ qe eshte permendur nga AK nuk lejon asnje lloj pershkrimi te produktit apo funksionalitetit te produktit qe te ofertohe ky produkt i ashtequajtur ‘ekuivalent’ nga operatoret ekonomike. Sipas nenit 36 te LPP-se, pika 4, citohet qe: ‘Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.’ Duke qene se per kete brand ka distributor ne Shqiperi, atehere operoret e tjere ekonomike nuk mund te marrin letren e autorizimit, duke cuar automatikisht ne nje fitues te paracaktuar. Kjo gje ngushton artificialisht konkurrencen, duke ulur numrin e operatoreve ekonomike pjesemarres, dhe duke sjell nje gare te padrejte dhe te njeanshme. Si edhe nuk mund te sillen mostrat qe i perkasin produkteve te brendit Stellaris, per aq kohe sa nuk kemi as autorizimin nga ky brend. Sipas pikes 2, te nenit 3 te Ligjit per Prokurimin Publik, citohet qe: ‘Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. **Se dyti**, AK kerkon te paraqiten mostra per te gjithë artikujt e kerkuar: ‘Per te gjithë artikujt e ofruar duhet te paraqesin mostra ditën dhe oren e hapjes se ofertave’. Mirepo duke u bazuar ne specifikimet teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor cojne ne konfuzion operatorin ekonomik, se cilin produkt duhet te ofertoje. Specifikimet teknike te vendosura nga AK jane shume evazive, duke mundesuar ofrimin e disa llojeve produktesh per te njejtin artikull. Specifikimet teknike duhet te jene te sakta, te qarta, te panenkuptuara, duke cuar ne ofertimin e vetem ne nje lloji produkti qe AK kerkon. Sipas pikes 2 te nenit 40 te VKM-se nr 285 per Miratimin e rregullave te Prokurimit Publik: ‘Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore*

parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.’ Sipas pikes 2 dhe 4 te nenit 36 te LPP-se: ‘Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. ‘Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. **Keshtu, per artikullin nr.6,** ngreme pretendimin qe jane perdorur specifikimet nga kompania prodhuese Bausch Surgcal. Gjate kontrollit te katalogut te kesaj kompanie, e cila e ndan kete produkt ne disa kategori dhe nje nder to eshte SofPort. Te gjitha brandet qe tregtojne kete lloj produkti nuk kane nje diopter aq sa AK ka kerkuar ne specifikimet teknike. Te gjitha vijne ne nje diapazon 10 deri ne 30D. Duke qene se AK ka pershkruar produktin ne nje menyre jo te qarte, dhe qe sjell konfuzion per ofertuesit, pervec OE qe mund te prezantoje mostren si dhe autorizimin e kompanise Bausch Surgical, te dy keto kritere jane barriera qe te coje ne nje pjesemarrres te vetem dhe nje fitues i paracaktuar. **KERKOJME TE HIQEN AUTORIZIMET DHE MOSTRAT SI DHE TE QARTESOHET PRODUKTI NE TERMAT E EKUIVALENCES, JO NE KRITERET QE E BEJNE BAUSCH TE PAKONKURUESHEM, NGA KOMPANITE E TJERA. Pershkrimi i artikullit nr.7** eshte i paqarte per termin e perdorur ‘ekuivalent’. Ky produkt sic permendet brandi i kompanise Bausch, Stellaris eshte teper specifik dhe prerjen 2.85-3.00 mm e ofron vetem kjo kompani. Edhe per kete artikull pervec pershkrimit te produktit 100% sipas nje brandi te caktuar, jane kerkuar mostra dhe letra autorizimi, duke bere te mundur qe te marre pjese vetem nje operator ekonomik, qe do te perfaqesoje kompanine Bausch. **KERKOJME TE HIQEN AUTORIZIMET DHE MOSTRAT SI DHE TE QARTESOHET PRODUKTI NE TERMAT E EKUIVALENCES, JO NE KRITERET QE E BEJNE BAUSCH TE PAKONKURUESHEM, NGA KOMPANITE E TJERA. Ne shtojcen 7 ‘Kriteret e Veçanta të Kualifikimit’** autoriteti kontraktor ka kerkuar qe operatori ekonomik te paraqese autorizim prodhuesi: ‘Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejjimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe të noterizuar)’ Per artikujt e sipermendur autoriteti kontraktor ka permendur emer brendi Stellaris dhe pikerisht specifikimet teknike jane hartuar sipas produkteve te ketij brendi qe eshte e kompanise prodhuese Bausch. Nderkohe termi ‘ekuivalent’ qe eshte permendur nga AK nuk lejon asnje lloj pershkrimi te produktit apo funksionalitetit te produktit qe te ofertohe ky produkt i ashtequajtur ‘ekuivalent’ nga operoret ekonomike.

Sipas nenit 36 te LPP-se, pika 4, citohet qe: ‘Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.’

Duke qene se per kete brand ka distributor ne Shqiperi, atehere operoret e tjere ekonomike nuk mund te marrin letren e autorizimit, duke cuar automatikisht ne nje fitues te paracaktuar.

Kjo gje ngushton artificialisht konkurrencen, duke ulur numrin e operatoreve ekonomike pjesemarres, dhe duke sjell nje gare te padrejte dhe te njeanshme. Si edhe nuk mund te sillen mostrat qe i perkasin produkteve te brendit Stellaris, per aq kohe sa nuk kemi as autorizimin nga ky brend. Sipas pikes 2, te nenit 3 te Ligjit per Prokurimin Publik, citohet qe: 'Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

***Se dyti,** AK kerkon te paraqiten mostra per te gjithë artikujt e kerkuar: 'Per te gjithë artikujt e ofruar duhet te paraqesin mostra ditën dhe oren e hapjes se ofertave'. Mirepo duke u bazuar ne specifikimet teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor cojne ne konfuzion operatorin ekonomik, se cilin produkt duhet te ofertoje. Specifikimet teknike te vendosura nga AK jane shume evazive, duke mundesuar ofrimin e disa llojeve produktesh per te njejtin artikull. Specifikimet teknike duhet te jene te sakta, te qarta, te panenkuptuara, duke cuar ne ofertimin e vetem ne nje lloji produkti qe AK kerkon.*

Sipas pikes 2 te nenit 40 te VKM-se nr 285 per Miratimin e rregullave te Prokurimit Publik: 'Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.' Sipas pikes 2 dhe 4 te nenit 36 te LPP-se: 'Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 'Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Keshtu, per artikullin nr.6,** ngreme pretendimin qe jane perdorur specifikimet nga kompania prodhuese Bausch Surgcal. Gjate kontrollit te katalogut te kesaj kompanie, e cila e ndan kete produkt ne disa kategori dhe nje nder to eshte SofPort. Te gjitha brandet qe tregtojne kete lloj produkti nuk kane nje diopter aq sa AK ka kerkuar ne specifikimet teknike. Te gjitha vijne ne nje diapazon 10 deri ne 30D. Duke qene se AK ka pershkruar produktin ne nje menyre jo te qarte, dhe qe sjell konfuzion per ofertuesit, pervec OE qe mund te prezantoje mostren si dhe autorizimin e kompanise Bausch Surgical, te dy keto kriteret jane barriera qe te coje ne nje pjesemarres te vetem dhe nje fitues i paracaktuar. **KERKOJME TE HIQEN AUTORIZIMET DHE MOSTRAT SI DHE TE QARTESOHET PRODUKTI NE TERMAT E EKVIVALENCES, JO NE KRITERET QE E BEJNE BAUSCH TE PAKONKURUESHEM, NGA KOMPANITE E TJERA. Pershkrimi i artikullit nr.7** eshte i paqarte per termin e perdorur 'ekuivalent'. Ky produkt sic permendet brandi i kompanise Bausch, Stellaris eshte teper specifik dhe prerjen 2.85-3.00 mm e ofron vetem kjo kompani. Edhe per kete artikull pervec pershkrimit te produktit 100% sipas nje brandi te caktuar, jane kerkuar mostra dhe letra autorizimi, duke bere te mundur qe te marre pjese vetem nje operator ekonomik, qe do te perfaqesoje kompanine Bausch. **KERKOJME TE HIQEN AUTORIZIMET DHE MOSTRAT SI DHE TE QARTESOHET PRODUKTI NE TERMAT E EKVIVALENCES, JO NE KRITERET QE E

*BEJNE BAUSCH TE PAKONKURUESHEM, NGA KOMPANITE E TJERA. Gjithashtu edhe artikulli nr 11, i perket kompanise Bausch. Eshte lehtesisht e identifikueshme se sa e paqarte eshte ne pershkrimin e produktit apo specifikimeve teknike. Ky artikull arrihet te identifikohet qe eshte Stellaris per shkak te permendjes se brandit nga AK. Po ketu shprehim te njejtin mendim qe kjo nuk e ndihmon palen e operatoreve ekonomik te gjeje njevlefshmerine e funksionalitetit apo pershkrimit te produktit tek termi 'ekuivalent'. Pervec kesaj edhe vete kategoria e produkteve Stellaris nuk mund te caktohet me aq pershkrim sa eshte permendur ne kete specifikime. Bashkengjitur do te gjeni pjese katalogu te kompanise Bausch qe verteton se jane disa produkte dhe pershkrimi nuk eshte bere i sakte por eshte konfuzion per operatorin ekonomik, se cilin produkt kerkon AK. **KERKOJME TE HIQEN AUTORIZIMET DHE MOSTRAT SI DHE TE QARTESOHET PRODUKTI NE TERMAT E EKUIVALENCES, JO NE KRITERET QE E BEJNE BAUSCH TE PAKONKURUESHEM, NGA KOMPANITE E TJERA.** (Bashkangjitur do te gjeni katalogun nga Bausch per keto artikujt). Ajo cfare vihet ne dukje nga AK, eshte pershkrimi shume i qarte per artikujt e tjere, te cilet jane lehtesisht te gjendshem dhe qe e bejne konkurencen te ndershme dhe transparente. Por per 3 artikujt e BAUSCH eshte e padrejte menyra e pershkrimit te specifikimeve teknike qe sjell konfuzion tek te gjithë operoret ekonomike te interesuar per pjesemarrje ne kete procedure, duke kufizuar artificialisht konkurencen.” **Gjithashtu edhe artikulli nr 11, i perket kompanise Bausch. Eshte lehtesisht e identifikueshme se sa e paqarte eshte ne pershkrimin e produktit apo specifikimeve teknike. Ky artikull arrihet te identifikohet qe eshte Stellaris per shkak te permendjes se brandit nga AK. Po ketu shprehim te njejtin mendim qe kjo nuk e ndihmon palen e operatoreve ekonomik te gjeje njevlefshmerine e funksionalitetit apo pershkrimit te produktit tek termi 'ekuivalent'. Pervec kesaj edhe vete kategoria e produkteve Stellaris nuk mund te caktohet me aq pershkrim sa eshte permendur ne kete specifikime. Bashkengjitur do te gjeni pjese katalogu te kompanise Bausch qe verteton se jane disa produkte dhe pershkrimi nuk eshte bere i sakte por eshte konfuzion per operatorin ekonomik, se cilin produkt kerkon AK. **KERKOJME TE HIQEN AUTORIZIMET DHE MOSTRAT SI DHE TE QARTESOHET PRODUKTI NE TERMAT E EKUIVALENCES, JO NE KRITERET QE E BEJNE BAUSCH TE PAKONKURUESHEM, NGA KOMPANITE E TJERA.** (Bashkangjitur do te gjeni katalogun nga Bausch per keto artikujt). Ajo cfare vihet ne dukje nga AK, eshte pershkrimi shume i qarte per artikujt e tjere, te cilet jane lehtesisht te gjendshem dhe qe e bejne konkurencen te ndershme dhe transparente. Por per 3 artikujt e BAUSCH eshte e padrejte menyra e pershkrimit te specifikimeve teknike qe sjell konfuzion tek te gjithë operoret ekonomike te interesuar per pjesemarrje ne kete procedure, duke kufizuar artificialisht konkurencen. **KERKOJME NGA AK: SAKTESIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE PER ARTIKUJT NR. 6, 7, 11.** Neqoftese AK kerkon produktet Bausch, **KERKOJME TE HIQEN AUTORIZIMET DHE MOSTRAT**, ne menyre qe te behet nje konkurrence e hapur dhe e ndershme. Ose ne qoftese AK i ka kaq te rendesishem keto elemente qe do ti marre nga kompania Bausch, **KERKOJME QE TE NDAHET KJO PROCEDURE NE LOTE DHE TE VECOJE KETO ARTIKUJ** per te lejuar pjesemarrje dhe konkurencen e drejte dhe te lire per pjesen tjeter te produkteve”***, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3, dhe 5 e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga AK është kërkuar si vijon:

3. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe të noterizuar).

5. Per te gjithë artikujt e ofruar duhet te paraqesin mostra ditën dhe oren e hapjes se ofertave. Dorezimi i Kapioneve /mostrave, te behet prane Sekretarise Spitali Rajonal Durres te mbyllura ne nje zarf/kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

“Mos e hapni me perjashtim te rasteve kur eshte i pranishem KVO te procedures se prokurimit “**Blerje Materiale Për Kirurgjinë E Kataraktës Për Spitalin Rajonal Durrës**” dhe jo para dates ne oren dhe datën e hapjes se tenderit.

Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te jape edhe nje shkrese te vulosur dhe te firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.

Mbi cdo moster te dorezuar ofertuesi duhet te shenoje nr rendor te artikullit qe perfaqeson sipas formularit te cmimit.

Ne paketimin e cdo mostre duhet te evidentohet qarte origjina e mallit e cila duhet te perputhet me origjinen e deklaruar nga ofertuesi.

Nese mostrat e dorezuara nuk jane te shoqeruara me listen e inventarizimit dhe te identifikuara sipas nr rendor te formularit te cmimit nese ka mungesa mostrash per artikuj te vecante ose nese origjina e stampuar mbi moster nuk perputhet me origjinen e deklaruar nga ofertuesi ateher oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.

III.4.2. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 750/3 prot., datë 16.05.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje mbi ankesën, protokolluar me tonën me nr. 750 prot., datë 10.05.2024”, si dhe Vendimit të KSHA-së, nr. 750/2 prot., datë 15.05.2024, bashkëngjitur kësaj shkrese, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK si me poshtë:

Sipas DST Shtojca 7. Referuar pretendimit OE ankimues

Duke qenë se bëhet fjalë për tregtim të mallrave në vendin tonë, atëherë dokumenti shoqëruar që e vërteton këtë fakt është pikërisht autorizimi nga prodhuesi i mallrave / distributori i autorizuar nga prodhuesi, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. Autorizimi nga prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e ti; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues. [...].

Referuar pretendimit të OE ankimues se kërkesa për mostra pasi AK i kërkon mostrat saktësisht si bazë ligjore për kërkimin e tyre por edhe arsyeja pse AK i kërkon mostrat, konkretisht është saktësuar ARGUMENTIMI: Në përputhje me nenin 40. Pika 6 Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra e mallit kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike [...]. **Nuk pranohet.**”

III.4.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; 12 c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe

jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.4.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe 13 personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.4.6. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3, 6 dhe 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

[...] “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor

duhet të përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. [...] 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.4.7. Nga shqyrtimi i “Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”, të publikuar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me kriterin e mësipërm, ky i fundit argumentuar:

“3. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejitimin e tregëtimit të artikujve të tij.(të përkthyer dhe të noterizuar).

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenin 11 dhe në nenin 12 të Ligjit nr. 105/2014 “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”. Autorizimi nga Prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

5.Per të gjithë artikujt e ofruar duhet të paraqesin mostra ditën e hapjes së ofertave ,me date në datën e dhe orën e hapjes së tenderit . Dorezimi i Kapioneve /mostrave, të behet pranë Sekretarisë Spitali Rajonal Durres të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shenohet:

“Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm KVO të procedurës së prokurimit “**Blerje Materiale Për Kirurgjinë E Kataraktës Për Spitalin Rajonal Durrës**” dhe jo para datës në datën dhe orën e hapjes së tenderit

Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkrues të vulosur dhe të firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti

Mbi cdo mostër të dorëzuar ofertuesi duhet të shenojë nr rendor të artikullit që përfaqëson sipas formularit të cmimit.

Në paketimin e cdo mostre duhet të evidentohet qarte origjina e mallit e cila duhet të perputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.

Nese mostrat e dorezuara nuk jane te shoqeruara me listen e inventarizimit dhe te identifikuara sipas nr rendor te formularit te cmimit nese ka mungesa mostrash per artikuj te vecante ose nese origjina e stampuar mbi moster nuk perputhet me origjinen e deklaruar nga ofertuesi ateher oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.

Artikujt duhet te kene ½ dates se prodhimit me daten e skadences.

Argumentimi: Ky kriter eshte ne perputhje me nenin nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...]. Paraqitja e katalogëve apo skedave teknike për artikullin që është objekt prokurimi, është kërkuar me qellim verifikimin e përputhshmërisë të materialeve mjekësore që operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike të percaktuara në DST, për të bërë të mundur vleresimin e tyre dhe përmbushjen e kërkesave të DST.

III.4.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e percaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.9. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe **parimin e kontradiktoritetit**, Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe pretendimet e ankimuesit. Në datën dhe orën e caktuar për mbajtjen e seancës dëgjimore u paraqit vetëm përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues, ndërsa përfaqësuesit e autoritetit kontraktor nuk u paraqitën, megjithë njoftimin e bërë në formë

shkresore nëpërmjet shërbimit postar të Postës Shqiptare sh.a dhe nëpërmjet postës elektronike të autoritetit kontraktor.

Në rastin konkret, ankimesi ngre pretendime, se artikujt e sipërmendur autoriteti kontraktor ka përmendur emër brendi Stellaris dhe pikërisht specifikimet teknike janë hartuar sipas produkteve të këtij brendi që është e kompanisë prodhuese Bausch. Nderkohe termi 'ekuivalent' që është përmendur nga AK nuk lejon asnjë lloj përshkrimi të produktit apo funksionalitetit të produktit që të ofertohej ky produkt i ashtequajtur 'ekuivalent' nga operatorët ekonomikë . Duke qenë se për këtë brand ka distributor në Shqipëri, atëherë operatorët e tjerë ekonomikë nuk mund të marrin letrën e autorizimit, duke cuar automatikisht në një fitues të paracaktuar. Kjo gjë ngushton artificialisht konkurrencën, duke ulur numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, dhe duke sjell një garë të padrejtë dhe të njëanshme. Si edhe nuk mund të sillen mostrat që i përkasin produkteve të brendit Stellaris, për atë kohë sa nuk kemi as autorizimin nga ky brend. Kështu, për artikullin nr.6, ngre pretendimin që janë përdorur specifikimet nga kompania prodhuese Bausch Surgical. Gjate kontrollit të katalogut të kësaj kompanie, e cila e ndan këtë produkt në disa kategori dhe një ndër to është SofPort. Të gjitha brandet që tregtojnë këtë lloj produkti nuk kanë një diopter atë sa AK ka kërkuar në specifikimet teknike. Të gjitha vijne në një diapazon 10 deri në 30D. Duke qenë se AK ka përshkruar produktin në një mënyrë jo të qartë, dhe që sjell konfuzion për ofertuesit, përveç OE që mund të prezantojë mostrën si dhe autorizimin e kompanisë Bausch Surgical, të dy këto kritere janë barrierë që të çojë në një pjesëmarrës të vetëm dhe një fitues i paracaktuar. Për artikullin nr.7 është i paqartë për termin e përdorur 'ekuivalent'. Ky produkt sic përmendet brandi i kompanisë Bausch, Stellaris është tepër specifik dhe prerjen 2.85-3.00 mm e ofron vetëm kjo kompani. Edhe për këtë artikull përveç përshkrimit të produktit 100% sipas një brandi të caktuar, janë kërkuar mostra dhe letra autorizimi, duke bërë të mundur që të marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, që do të përfaqësojë kompaninë Bausch. Për artikullin nr 11, i përket kompanisë Bausch. Është lehtësisht e identifikueshme se sa e paqartë është në përshkrimin e produktit apo specifikimeve teknike. Ky artikull arrihet të identifikohet që është Stellaris për shkak të përmendjes së brandit nga AK. Po këtu shprehim të njëjtin mendim që kjo nuk e ndihmon palën e operatorëve ekonomikë të gjejë një vlefshmerinë e funksionalitetit apo përshkrimi të produktit tek termi 'ekuivalent'. Përveç kësaj edhe vete kategoria e produkteve Stellaris nuk mund të caktohet me atë përshkrim sa është përmendur në këtë specifikim. Bashkëngjitur do të gjeni pjesë katalogu të kompanisë Bausch që verteton se janë disa produkte dhe përshkrimi nuk është bërë i saktë por është konfuzion për operatorin ekonomik, se cilin produkt kërkon AK.

Për këto arsye, ankimesi kërkon të hiqen autorizimet dhe mostrat për tre artikujt e sipërcituar, të ndryshohen specifikimet teknike të tyre ose të prokurohen më vete këta tre artikuj.

Sa më sipër, KPP, gjykon se autoriteti kontraktor ka dështuar në argumentimin për paraqitja e autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar dhe mostrave është e përshtatshme për arrijtjen e synimit të kërkuar dhe se kjo kërkesë nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, nga ana e këtij të fundit nuk jepet asnjë sqarim lidhur me faktin e përmendur nga ankimesi, se këta tre artikuj sigurohen nga kompania Bausch Surgical, dhe të dyja këto kritere janë barrierë që të çojnë në një pjesëmarrës të vetëm dhe një fitues i paracaktuar. Këto pretendime të ankimesit, nuk u arrit të sqarohen as në seancën dëgjimore të datës 31.05.2024, ora 12:00, për mungesë të përfaqësuesve të AK. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb

konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron. ”

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të procedurës së re të prokurimit të publikuar në SPE, konstatohet se në pikën 5 të “Kapacitetit teknik”, të “Kritereve të vecanta të kualifikimit”, shtojca 7 e DT-ve, është kërkuar:

“Referuar Vendimit të KPP me nr 621/2024 date 04.06.2024 dhe nr. 833/4 prot date 07.06.2024, por mostrat do të shikohen/vlersohen në momentin e dyte procedural te kontrollit ex-post, pas lidhjes së kontrates, ku komisioni perkates i pritjes së mallit duhet të kontrolloj përputhshmerine e produkteve të furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar nga autoritetit kontraktor.”

Kriteri i kualifikimit për paraqitjen e mostrave pas lidhjes së kontratës nuk gjen mbështetje ligjore dhe bie në kundërshtim me nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin,

punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe 13 personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Gjithashtu rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë ndryshim apo sqarim lidhur me pretendimet dhe paqartësitë e ankimesit përsa i përket kërkesës “*Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij.(të përkthyer dhe të noterizuar)*”, në kundërshtim me konstatimet e KPP-së, trajtuar hollësisht në pikën III.4. të arsyetimit të vendimit nr.621/2024, datë 04.06.2024 si më sipër cituar.

Vetëm pas zbatimit të plotë të vendimeve Nr. 621/2024, datë 04.06.2024 dhe Nr.840/2024, datë 09.07.2024 të KPP-së, autoriteti kontraktor do të lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimesi.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”. Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Blerje materiale për kirurgjinë e kataraktës për Spitalin Rajonal Durrës*”, me fond limit 4,546,300 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimet Nr. 621/2024, datë 04.06.2024 dhe Nr.840/2024, datë 09.07.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

